



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I AKCIZËS

Nr. 13547/1 Prot.

Tiranë më, 30/5 / 2016

Drejtuar: **TË GJITHA DEGËVE DOGANORE** ✓

Lënda: *Për njohje dhe zbatim*


Bashkëlidhur kësaj shkrese keni manualin “*Mbi rregullat dhe procedurën për dhënien e autorizimit për magazinë fiskale si dhe për miratimin e shtesa/modifikimeve në autorizim*”, protokolluar nr. 13547 datë 27.05.2016.

Merrni masa për njohjen dhe zbatimin e tij.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Ylber KARANXHA

ZV.DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 13547 Prot.

Tiranë më, 27/05 / 2016

MANUAL

MBI RREGULLAT DHE PROCEDURËN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR MAGAZINË FISKALE SI DHE PËR MIRATIMIN E SHTESAVE/MODIFIKIME NË AUTORIZIM

1. QËLLIMI

- Të specifikojë përgjegjësitë, autoritetet, personat përgjegjës dhe veprimet që do të kryhen për pajisjen me autorizim të gjithë atyre që kërkojnë të përfitojnë statusin e magazinës fiskale prodhimi/përpunimi/stokimi të produkteve të akcizës.
- Të specifikojë përgjegjësitë, autoritetet, personat përgjegjës dhe veprimet që do të kryhen në rastet kur depozituesit e miratuar kërkojnë shtesa/modifikime në autorizimet e tyre aktive.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Zbatohet për të gjithë operatorët ekonomik që kërkojnë/aplikojnë të marrin statusin e magazinës fiskale prodhimi/përpunimi/stokimi, dhe për këtë ligji i detyron të pajisen me autorizim, si dhe për të gjithë depozituesit e miratuar që kërkojnë miratimin e shtesave/modifikimeve të ndryshme në autorizim.

3. TERMINOLOGJA DHE SHKURTIME

Magazinë fiskale - është një ambient, qartësishët i ndarë nga ambientet e tjera, ku produktet e akcizës prodhohen, përpunohen, mbahen, priten ose dërgohen nën një regjim pezullues të detyrimeve nga një depozitues i miratuar në ushtrimin e aktivitetit të tij, sipas kushteve të përcaktuara nga autoritetet doganore.

Autorizim akcize - është autorizimi i lëshuar nga autoritetet doganore ndaj një personi fizik ose juridik, përmes të cilët këta të fundit, si pjesë e aktivitetit të tyre, mund të presin, të prodhojnë, të ruajnë, të magazinojnë ose të kryejnë operacione të tjera me produktet e akcizës në magazinat fiskale dhe të dërgojnë produkte akcize nën regjin e pezullimit të detyrimeve.

Verifikim teknik - është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat teknike.

Dega doganore mbikëqyrëse (DDM) - dega doganore e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mbikëqyrjen e depozituesit të miratuar.

DPD - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4. DOKUMENTAT REFERUESE.

- Ligj 61/2012, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- VKM Nr. 612, datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat” i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 2 datë 27.09.2012 “Mbi përcaktimin e masës së garancisë për magazinat fiskale të prodhimit përpunimit, stokimit dhe në lëvizjen e mallrave të akcizës nën pezullim” i ndryshuar.

5. PROCEDURA PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT

Nr	Proçesi/Nënproçesi	Struktura përgjegjëse	Personi përgjegjës	Dokumenti që plotësohet	Afati kohor
1	Kërkuar aplikon pranë degës doganore me anë të një kërkese tip sipas formularit të aneksit 11 të VKM 612, bashkëngjitur me dokumentacionin e kërkuar	DDM	Specialisti i protokollit	Protokollim i kerkeshes sipas rregullave të protokollit	Menjëherë, pas dorëzimit të kërkeshës

	sipas Aneksit 2 të këtij manuali				
2	Kryetari i degës doganore, me paraqitjen e kërkesës dhe të dosjes përkatëse, nxjerr urdhrin për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe kryerjen e vizitës në ambientet e planifikuara për t'u përdorur si magazinë fiskale.	DDM	Kryetari i DDM	Urdhëri për ngritjen e grupit të punës (Aneksi 1)	Jo më vonë se dy ditë pune nga protokollimi i kërkesës
3	Kryhet shqyrtimi i dokumentacionit që përbën dosja dhe vlefshmëria e tij.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbal i verifikimit të dokumentacionit (Aneksi 2)	Jo më vonë se dy ditë pune nga marrja e urdhërit
4	Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezultojnë mangësi në dokumentacion, zyra doganore njofton (e-mail; tel; me shkrim) aplikuesin për mangësitë e konstatuara.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Njoftimi i i aplikuesit	Jo më vonë se një ditë pune nga shqyrtimi i dokumentacionit
4/1	Pas plotësimit të mangësive të konstatuara në dokumentacion, procédohet njësoj, duke filluar nga rreshti tre i kësaj tabele	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit		
5	Nëse nga shqyrtimi /rishqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi rezulton që nuk ka mangësi në dokumentacion, atëherë, doganierët e ngarkuar kryejnë vizitën në ambientet e planifikuara për t'u përdorur si magazinë fiskale me qëllim verifikimin teknik.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit		Vizita kryhet jo më vonë se 7 ditë nga protokollimi i kërkesës
6	Kryhet verifikimi teknik duke ndjekur të gjithë hapat sipas udhëzimit mbi verifikimin teknik	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbal i verifikimit teknik (sipas udhëzimit për verifikimin teknik) (Aneksi 3)	
6/1	Nëse nga verifikimi teknik i ambienteve, rezultojnë mangësi, i bëhen me dije aplikuesit për mangësitë e konstatuara, duke lënë edhe detyrat përkatëse.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbal i verifikimit teknik fillestar (Aneksi 3)	
7	Në rast se në vizitën për verifikimin teknik është kërkuar asistenza e specialistëve të drejtorisë teknike, atëherë këta të fundit bëhen pjesë e proçesit të verifikimit teknik.	DDM, Sektori i pajisjeve & linjave teknologjike	Doganierët e akcizës, specialistë të sektorit PMLT	Proçesverbal i verifikimit teknik fillestar (Aneksi 3)	Jo më vonë se tre ditë pune nga kërkesa për asistencë nga dega doganore
8	Bazuar në aneksin 2 dhe 3, hartohet një raport përbledhës dhe i paraqitet kryetarit të degës.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbal i Raportit përbledhës (Aneksi 4)	Jo më vonë se dy ditë nga vizita e kryer në ambientet e planifikuara për t'u përdorur si magazinë fiskale
8/1	Nëse nga konkluzionet e raportit përbledhës rezultojnë mangësi në dokumentacion apo problematika që cënojnë	DDM	Përgjegjësi i zyrës së akcizës/ Kryetari i	Njoftimi me shkrim për refuzim të kërkesës duke shpjeguar edhe	Brenda 14 (katërmبëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës

	funksionimin korrekt të regjimit të magazinës fiskale dhe mbikëqyrjes së tij, zyra doganore i kthen përgjigje kërkuesit, për pezullim të procedurave të mëtejshme, duke shpjeguar arsyet përkatëse dhe mangësitë e konstatuara.		DDM	shkaqet e refuzimit	
8/2	Nëse nga konkluzionet e raportit përmbledhës rezulton që nuk ka mangësi në dokumentacion apo problematika që cënojnë funksionimin korrekt të regjimit të magazinës fiskale dhe mbikëqyrjes së tij, zyra doganore, përcjell për procedim të mëtejshëm dosjen e plotë të depozitar nga kërkuesi, duke mbajtur pranë saj një kopje identike, si dhe e shoqëron atë edhe me opinionin e saj zyrtar në lidhje me kërkuesin dhe mundësinë e mbikëqyrjes e të kontrollit të magazinës fiskale.	DDM	Përgjegjësi i zyrës së akcizës/ Kryetari i DDM	Dokumenti "Opinion Mbi kërkesën për Autorizim për administrim të magazinës fiskale (Aneksi 5)	Jo më vonë se dy ditë nga hartimi i raportit përmbledhës, (Aneksi 4)
9	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas marrjes së dosjes së plotë të kërkuesit dhe opinionit zyrtar të zyrës doganore, shqyron dokumentacionin e paraqitur dhe, në rast se e gjykon të arsyeshme , mund: a) të kërkojë informacione shtesë brenda apo jashtë institucionit; b) të kryejë vizitë shtesë në ambientet e planifikuar për magazinën fiskale nëse ka nevojë për saktësimë apo riverifikime.	DPD	Drejtoria teknike. Sektori i autorizimeve	Hartohet shkresa për informacione shtesë ose plani i punës për kryerjen e vizitës shtesë në ambientet e planifikuar për magazinën fiskale	Jo më vonë se dy ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit nga sektori i autorizimeve
10	Në rast se kërkuesat konsiderohen të paplotësuara, njoftohet zyrtarisht dega doganore dhe operatori ekonomik për shkaqet e mosaprovimit të autorizimit.	DPD	Sektori i autorizimeve	Hartohet shkresa për mosaprovim	Jo më vonë se katër ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit nga sektori i autorizimeve
11	Në rast se plotësohen të gjitha kërkuesat e parashikuara, hartohet një relacion shpjegues i cili jep informacion mbi përbajtjen e dosjes dhe opinionin e sektorit.	DPD	Sektori i autorizimeve	Aneksi 6 (relacioni shpjegues)	Jo më vonë se katër ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit nga sektori i autorizimeve
12	Lëshohet autorizimi përkatës, pasi të janë gjeneruar në sistemin informatik kodet fiskale specifike. Autorizimet lëshohen pa afat kohor. Kopje e autorizimit i dërgohet edhe	DPD	Sektori i autorizimeve	Aneksi 12	Jo më vonë se katër ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit nga sektori i autorizimeve

	degës doganore.				
13	Pas marrjes së kopjes së autorizimit të protokolluar, njoftohet operatori për tu pajisur me USER dhe KODIN përkatës që do të shërbejnë për akses në sistemin ASYCUDA.WORLD	DPD	Sektori i autorizimeve		Menjëherë pas marrjes së kopjes autorizimit të protokolluar
14	Hidhet manualisht ASYCUDA WORLD në kompjuterin e operatorit, si dhe i jepet manual i përdorimit të sistemit.	DPD/ DDM	IT në DDM ose në DPD		
15	Kryhen veprimet në sistem me qëllim aktivizimin e magazinës.	DPD	Sektori i autorizimeve	Aneksi 7 (veprimet që kryhen në sistem)	Menjëherë pas pajisjes me USER dhe KOD

6.1 PROCEDURA PËR SHTESA / MODIFIKIME DHE NDRYSHIME NË AUTORIZIM

Procedura që ndiqet për çdo kërkesë të paraqitur për ndryshim, shtesa, modifikim në autorizimin e dhënë eshtë pothuajse e njëjtë me procedurën e dhënies së autorizimit fillestar.

Ndryshimi i vetëm në këtë rast eshtë në përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë aplikuesi dhe verifikimin që duhet të bëhet nga Autoriteti Doganor për ndryshimin, apo shtesën e kërkuar.

Nr	Proçesi/Nënproçesi	Struktura përgjegjëse	Personi përgjegjës	Dokumenti që plotësohet	Afati kohor
1	Kërkuesi aplikon/informon pranë degës doganore me anë të një kërkesë lidhur me çdo ndryshim apo modifikim, që lidhet me depozitat, rezervuarët, instalimet, kushtet e shfrytëzimit të magazinës fiskale dhe çdo ndryshim në dokumentacionin e dorëzuar për marrjen e autorizimit.	DDM	Specialisti i protokollit	Protokollim i kërkesës sipas rregullave të protokollit	Menjëherë, pas dorëzimit të kërkesës
2	Kryetari i degës doganore, me paraqitjen e kërkesës, autorizon doganierin/ët mbikqyrës për shqyrtimin e kërkesës pra kontrollin, verifikimin dhe vlerësimin.	DDM	Kryetari i DDM	Lihet shënimi mbi kërkesë për shqyrtimin e kërkesës	Jo më vonë se dy ditë pune nga protokollimi i kërkesës
3	Kryhet shqyrtimi i kërkesës dhe në varësi të saj i kërkohet operatorit (e-mail; tel; me shkrim) dokumentacioni i nevojshëm.	DDM	Doganierët e autorizuar	Njoftimi i operatorit	Jo më vonë se dy ditë pune nga marrja e urdhërit
4	Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezultojnë mangësi në dokumentacion, zyra doganore njofton (e-mail; tel; me shkrim) aplikuesin për mangësitë e	DDM	Doganierët e autorizuar	Proçesverbal i verifikimit të dokumentacionit (Aneksi 2)	Jo më vonë se një ditë pune nga shqyrtimi i dokumentacionit

	konstatuara.				
4/1	Pas plotësimit të mangësive të konstatuara në dokumentacion, procëdohet njësoj, duke filluar nga rreshti 4 i kësaj tabele.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit		
5	Nëse nga shqyrtimi/ rishqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi rezulton që nuk ka mangësi në dokumentacion, atëherë, doganierët e ngarkuar kryejnë vizitën në ambientet e magazinës fiskale me qëllim verifikimin teknik .	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit		Respektohen të njëjtat afate kohore si kërkesa fillestare. Vizita kryhet jo më vonë se 7 ditë nga protokollimi i kërkesës
6	Kryhet verifikimi teknik duke ndjekur të gjithë hapat sipas udhëzimit mbi verifikimin teknik.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbali i verifikimit teknik (sipas udhëzimit për verifikimin teknik) (Aneksi 3)	
7	Nëse nga verifikimi teknik i ambienteve, rezultojnë mangësi, i bëhen me dije aplikuesit për mangësitë e konstatuara, duke lënë edhe detyrat përkatëse.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbali i verifikimit teknik fillestare (Aneksi 3)	
8	Bazuar në aneksin 2 dhe 3, hartohet një raport përbledhës dhe i paraqitet kryetarit të degës.	DDM	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Proçesverbali i Raportit permbledhës (Aneksi 4)	Jo më vonë se një ditë nga vizita e kryer në ambientet e planifikuara përt'u përdorur si magazinë fiskale
8/1	Nëse nga konkluzionet e raportit përbledhës rezultojnë mangësi në dokumentacion apo problematika që cenojnë funksionimin korrekt të regjimit të magazinës fiskale dhe mbikëqyrjes së tij, zyra doganore i kthen përgjigje kërkuesit, për pezullim të procedurave të mëtejshme, duke shpjeguar arsyet përkatëse dhe mangësitë e konstatuara.	DDM	Përgjegjësi i zyrës së akcizës/ Kretari i DDM	Njoftimi me shkrim për refuzim të kërkesës duke shpjeguar edhe shkaqet e refuzimit	Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marja e kërkesës
8/2	Nëse nga konkluzionet e raportit përbledhës rezulton që nuk ka mangësi në dokumentacion apo problematika që cenojnë funksionimin korrekt të regjimit të magazinës fiskale dhe mbikëqyrjes së tij, zyra doganore, përcjell për procedim të mëtejshëm dosjen e plotë të depozituar nga kërkuesi, duke mbajtur pranë saj një kopje identike, si dhe e shoqëron atë edhe me opinionin e saj zyrtar në lidhje me kërkesën dhe mundësinë e mbikëqyrjes e të kontrollit të magazinës fiskale.	DDM	Përgjegjësi i zyrës së akcizës/ Kretari i DDM	Dokumenti "Opinion Mbi kërkesën përshtesa apo ndryshim të magazinës fiskale (Aneksi 5.1)	Jo më vonë se dy ditë nga hartimi i raportit përbledhës, (Aneksi 4)

9	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vlerëson kërkesën e operatorit dhe opinionin e degës doganore për ndryshimet apo modifikimet në autorizimin fillestare.	DPD	Drejtoria teknike. Sektori i autorizimeve		
10	Në rast se kërkesat konsiderohen të paplotësuar, njoftohet zyrtarisht dega doganore dhe subjekti për shkaqet e mosaprovimit të ndryshimeve në autorizim.	DPD	Sektori i autorizimeve	Hartohet shkresa për mosaprovim	Jo më vonë se katër ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit nga sektori i autorizimeve
11	Në rast se kërkesat konsiderohen të plotësuar, miratohen ndryshime e këruara.	DPD	Sektori i autorizimeve	Hartohet shkresa për aprosim	Jo më vonë se katër ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit nga sektori i autorizimeve
12	Kryhen veprimet në sistem me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve (në varësi të ndryshimeve).	DPD	Sektori i autorizimeve		Menjëherë pas protokollimit të shkresës

* Verifikimi teknik mund të kryhet vetëm për qëllime të shtesave dhe modifikimeve të këruara ose për të gjithë magazinën fiskale. Në varësi të verifikimit teknik plotësohet edhe procesverbali përkatës.

7. RREGJISTRIMET E ZBATIMIT TE PROCEDURËS.

Nr. i Anekseve të këtij manuali	Titulli i formularit	Funksioni përgj. për plotësim të formularit	Kur plotësohet	Personi që ruan dokumentin
Aneksi 1	Urdhëri për ngritjen e grupit të punës	Kryetari i DDM	Në momentin e kur është paraqitur kërkesa për magazinë fiskale	D.doganore/arshiva e DDM
Aneksi 2	Procesverbali i verifikimit të dokumentacionit	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Në momentin e verifikimit të dokumentacionit	
Aneksi 3*	Procesverbali i verifikimit teknik	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Në momentin e kryerjes së verifikimit teknik në ambientet e subjektit	
Aneksi 4	Raporti përbledhës	Doganierët e ngarkuar sipas urdhërit	Pas plotësimit të anekseve 2 dhe 3	
Aneksi 5	Opinion mbi vlefshmërinë e dokumentacionit dhe plotësimin e kërkesave për magazinë fiskale	Kryetari i DDM/Përgjegjësi i zyrës akcizës	Në rast se raporti përbledhës është pozitiv	
Aneksi 5.1	Opinion mbi vlefshmërinë e dokumentacionit dhe plotësimin e kërkesave për ndryshime në	Kryetari i DDM/ Përgjegjësi i zyrës akcizës	Në rast se raporti përbledhës është pozitiv	


	autorizim			
Aneksi 6	Relacioni shpjegues	Sektori autorizimeve	Përpara se të lëshohet autorizimi nga sektori	Zyra arshivë/protokoll DPD
Aneksi 7	Veprimet që kryhen në sistem	Sektori autorizimeve	Kryhen pas marjes së autorizimit.	
Aneksi 11 i vkm 612, datë 05.09.2012	Kërkesa tip	Operatori	Kur aplikon për autorizim	
Aneksi 12 i vkm 612, datë 05.09.2012	Formati autorizimit	Sektori i autizimeve	Kur kërkesa për autorizim konsiderohet e plotësuar dhe dërgohet për miratim tek hallkat vijuese miratuese	Zyra arshivë/protokoll DPD

* Proçesverbali i verifikimit teknik (Aneksi 3) gjëndet bashkangjitur edhe në udhëzimin e verifikimit teknik

8. Dispozita të fundit

Ngarkohen për zbatimin e këtij manuali Degët Doganore dhe Departamenti i Akcizës.

Ky manual hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE.....

ANEKSI 1

URDHËR PUNE

Bazuar në nenit 51 të V.K.M-së nr.612 datë 05.09.2012 "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës" i ndryshuar, në vijim të kërkesës me nr.....prot., datë..... dhe dokumentacionit të depozituar me qëllim pajisjen me Autorizim Akcize për operatorin _____, urdhëroj ngritjen e grupit të punës si më poshtë:

1. _____.
2. _____.
3. _____.

Tematika e Kontrollit

1. Shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar (Aneksi 2)
2. Kryerja e vizitës, me qëllim verifikimin teknik, në ambientet e planifikuara për t'u përdorur si magazinë fiskale. (Aneksi 3)
3. Hartimi i raportit përbledhës (Aneksi 4)

Sa më sipër, operatori/aplikuesi të krijojë kushtet e nevojshme për ushtrimin e kontrollit dhe të vërë në dispozicion të grupit të kontrollit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar prej tij.

KRYETARI

DEGA DOGANORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE.....

ANEKSI 2

**Konfirmimi i dokumentacionit
Për dhënie autorizimi ose ndryshime në autorizim**

Nr.	Dokumentacioni	Vlefshmëria e dokumentacionit	Konform	Jo konform
1	Kopje e titullit të lejes apo liçencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit nëse subjekti për ushtrimin e aktivitetit duhet të pajiset me një liçencë apo leje të parashikuar nga shtojca e ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë	<p>Tipi dhe kategoria e lejes apo liçencës që paraqitet nga aplikuesi duhet të jetë në përputhje me llojin e aktivitetit për të cilën kërkohet autorizimi</p> <p>Psh. Në rast se kërkohet autorizim për prodhim/përpunim vajrash, duhet që edhe leja/licenca të jenë për prodhim/përpunim dhe jo psh për stokim</p>		
2	Prokura e përfaqësuesit ligjor për marrjen përsipër të përgjegjësive të shoqërisë, për rastet kur nuk përcaktohet në ekstraktin e QKR-së;	-		
3	Dëshmi penaliteti e përfaqësuesit të shoqërisë/administratorit dhe aksionarëve të shoqërisë.”.	-		
4	Planimetria e ambienteve të planifikuara për magazinë fiskale, të shoqëruara me foto për çdo plan si brenda ashtu edhe jashtë;	<p>Planimetria duhet të tregojë qartësisht të gjitha hyrje-daljet, ambientet e magazinës, vendodhjen e depozitave me kapacitetet përkatëse.</p> <p>Në varësi të madhësisë së objektit mund të jetë në formatin A₃, A₂ ose A₀. Dokumenti duhet të ketë të gjitha elementet identifikues të hartuesit dhe të pronësisë, datën e hartimit/revizionimit etj.</p>		
5	Plani dhe përshkrimi i instalimeve të ndryshme që do të jenë pjesë e magazinës fiskale (instalime, depo, rezervuarë, tubacione etj.);	<p>Skica duhet</p> <ul style="list-style-type: none">- Të jetë në formatin A₃, A₂ ose A₀.- Të paraqesë dhe identifikojë impiantet, tubacionet, të gjitha pompat, saraçineskat, rakorderitë, etj.		

		<ul style="list-style-type: none"> - Të paraqesë me ngjyra të ndryshme linjën e lëndës së parë, të produkteve të gatshëm, etj. - Të evidentojë drejtimi i lëvizjes së produkteve. <p>Dokumenti duhet të ketë të gjitha elementet identifikues të hartuesit dhe të pronësisë, datën e hartimit/revizionimit etj</p>		
6	Akti i kalibrimit të kontejnerëve (depozitave, sillosa etj.) nga DPM-ja, në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho. Për rastet kur marra e çertifikatës së kalibrimit është në proces, të depozitohet kërkesa e aplikimit shoqëruar me çertifikatat e kalibrimit të disponueshme në momentin e prodhimit/importit;	Për prodhuesit e verës Në varësi të llojit dhe kapacitetit të depozitave të shikohen nëse plotësohen kushtet sipas pikave 14, 19, 20, 21 të nenit 143 të VKM 612/2012		
7	Certifikimet përkatëse për instrumentet dhe pajisjet matëse nga DPM-ja;	Këto çertifikata kërkohen vetëm për pajisjet matëse. Për prodhuesit e vegjël, në rast se aplikuesi nuk disponon pajisje apo instrumenta matëse, i kërkohet të një listë e inventarit te pajisjeve me kapacitetet përkatëse		
8	Deklarata për natyrën dhe pozicionin tarifor të produkteve që priten, dërgohen, mbahen dhe në rastin e magazinave të prodhimit edhe të lëndëve të para dhe produkteve të prodhua	Pershkrimin dhe kodin tarifor sipas nomeklature së kombinuar të mallrave për lëndët e para dhe produktin përfundimtar <i>Psh. Rrush kodit NK 0806</i> <i>Verë kodit NK 2205</i>		
9	Karta teknologjike me parametrat e punës, lëndët e para dhe produktet përfundimtare të përfituarë sipas standardeve të përcaktuara më parë;	<p>Karta teknologjike duhet të paraqesë tërë procesin e prodhimit. Në të duhet të evidentohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lënda e parë/ Karakteristikat e saj. - Mënyra e furnizimit/ magazinimi i lëndës së parë. - Mënyra/ metoda e prodhimit/ përpunimit. - Operacionet/ proceset teknologjike. - Mjetet/ kushtet e punës. - Parametrat teknike/ teknologjike për çdo proces. - Normativat e prodhimit (Humbjet dhe firot). - Kapacitetet max të prodhimit ditor/ vjetor. - Kontrolli i cilësisë. - Lloji i energjisë së konsumuar dhe sasia/ njësi produkti. 		

		<ul style="list-style-type: none"> - Karta teknologjike të jetë e shoqëruar me skemën teknologjike (flow chart) <p>Karta teknologjike të jetë e firmosur nga personi përgjegjës për zbatimin e saj, i cili mund të jetë drejtuesi teknik ose teknologu</p>		
10	Vlerësimi i sasive të produkteve të akcizës të produara, të përpunuara dhe të depozituara/të stokuara për një periudhë të caktuar (vjetore apo që mbulan aktivitetin nëse është sezionale);			
11	Dokumenti i garancisë, tabela e llogaritjes	<p>Garancia referuar përcaktimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas aneksit 22 te Dispozitave Zbatuese të ligjit te Akcizës, - Udhëzim Nr. 2 datë 27.09.2012 Mbi përcaktimin e mases së garancisë për magaziat fiskale të prodhimit përpunimit, stokimit dhe në lëvizjen e mallrave të akcizes nën pezullim - Udhëzim Nr. 2/1 datë 04.06.2014 shtesë udhëzimi Nr. 2 "Mbi përcaktimin e masës së garancisë për magazinat fiskale të prodhimit përpunimit, stokimit dhe në lëvizjen e mallrave të akcizes nën pezullim" 		
12	Informacioni për sistemin kontabël që përdor shoqëria, si dhe masat e kontrollit të brendshëm e metodat e kontrollit që ajo përdor;			
13	Konfirmimi se shoqëria nuk ka asnjë detyrim të pashlyer ndaj administratës doganore në momentin e aplikimit.			

Emër Mbiemër

Firma

Data.....



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

ANEKSI 3

PROÇES-VERBAL

(Mbi verifikimin teknik të magazinës fiskale të prodhimit/përpunimit/stokimit të produkteve
të akcizës)

I mbajtur nga grupei i punës, i ngritur sipas programit kontrollit/me Urdhër nr. _____ prot.,
datë ____ / ____ / ____ për verifikimin teknik të magazinës fiskale prodhimi / përpunimi /
stokimi.

Shoqëria _____
Përfaqësuesi (Administratori): _____ Tel: _____
Përfaqësuesi i autorizuar : _____ Cel: _____
Përdoruesi i sistemit (modulit akcizës): _____ Fax: _____
NIPT : _____ e-mail: _____
Adresa e selisë: _____ e-mail: _____
Adresa magazinës: _____

1. Identifikimi i ambienteve

- Ambientet janë të ndara dhe të përshtatshme sipas funksioneve dhe proceseve që kryhen?
Po Jo
- Ambientet janë të ndara qartësisht nga ambientet e tjera? Po Jo
- Ambientet ku do të vendosen produktet me DSHA të paguar janë të ndara në mënyrë të
qartë nga ambientet e tjera? Po Jo
- Ambientet e denatyrimit të alkoolit etilik janë të ndara nga ambientet e prodhimit dhe
plotësojnë kushtet për denatyrim Po Jo

- Ambientet mbikqyren me pajisje vëzhguese (kamera)? Po Jo

2. Identifikimi i impianteve, depozitave, tubacioneve, aparaturave dhe instrumenteve të instaluara.

- Skica e instalimeve të impiantit dhe vendosjes së depove, tubacioneve pompave, saraçineskave, pajisjeve matëse, etj, përpushtet plotësisht me faktin? Po Jo
- Janë të identifikuara depozitat dhe pajisjet (nr. rendor, kapacitet, etj) ? Po Jo
- Janë të kalibruara/verifikuara nga DPM depozitat dhe pajisjet? Po Jo
- Ka një listë inventari me të dhënat tekniko-metrologjike për të gjitha pajisjet, depozitat, instrumentat, pajisjet matëse, etj.? Po Jo
(Nëse jo, lista e inventarit krijohet nga grupi i kontrollit dhe i bashkëngjitet dosjes).
- Tubacionet lidhëse janë të lidhura në mënyrë të tillë që të mos ketë shhangje? Po Jo
- Tubacionet e linjës janë të identifikuara me ngjyra ? Po Jo
- Tubacionet e linjës tregojnë me shigjeta drejtimin e rrjedhjes së lëngut? Po Jo
- Tubacionet e linjës janë të dukshme, ndiqen në mënyrë vizive dhe nuk janë të nëndhenschme? Po Jo
- Pajisjet matëse janë vendosur në hyrje dhe dalje kur kjo është e detyrueshme? Po Jo
- Pajisjet matëse janë vendosur në pikat fundore të daljes së tubacioneve të produktit përfundimtar të akcizës ose të përpunuar, konform skemës teknologjike? Po Jo
- Pajisjet matëse plotësojnë kushtet për plumbosje nga Autoritetet Doganore? Po Jo

3. Verifikimi i pajisjeve matëse

- Funksionojnë në mënyrë të rregullt instrumentat dhe aparatet e instaluara të matjes? Po Jo
- Pajisjet matëse janë të sigurta, të mos manipulohen dhe të mos falsifikohen? Po Jo
- Janë të përshtatshme pajisjet e matjes, për të garantuar mbrojtjen e interesave financiare? Po Jo
- Pajisjet matëse i janë nënshtuar procesit të kalibrimit/verifikimit? Po Jo

Shënime specifike për rastet e konstatuara “Jo□”

Konkluzione pas verifikimit teknik:

Pas verifikimeve të kryera rezulton se operatori:

- Ńshtë në përputhje me kërkesat.
 - Ńshtë pjesërisht në përputhje me kërkesat.
 - Nuk është në përputhje me kërkesat.

Detyra dhe afate

Rekomandime

Për grupin e kontrollit

Për Operatorin ekonomik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE.....

ANEKSI 4

RELACION PËRMBLEDHËS

Ky relacion , hartohej nga zyra e akcizës në degë doganore, në zbatim të procedurës për dhënen e Autorizimit për magazinë fiskale/ ndryshimeve në autorizim.

Qëllimi i këtij relacioni:

Është që të informojë në mënyrë të përbledhur Titullarin e Degës Doganore nëse dokumentacioni i paraqitur, dhe kushtet teknike, ambientale, metrologjike teknologjike etj, të magazinës fiskale (për të cilën aplikohet) / ndryshimeve në autorizim janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Përshtkimi

Operatori, ka paraqitur kërkesën për aplikim për magazinë fiskale/ ndryshime në autorizim pranë DD.....më datën

Grupi i punës në zbatim të urdhërit të punës nr. _____ prot., datë ____ / ____ / ____ brenda afateve ligjore/jashtë afateve ligjore në (shpjegohet arsyeha pse) ka shqyrtaur dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se dokumentacioni është i plotë dhe përmban të gjithë informacionin e kërkuar në të.

Vizita e kryer në ambientet e magazinës fiskale (aplikuesit) me qëllim verifikimin teknik u krye në datën ____ / ____ / ____ dhe në përfundim u mbajt procesverbali përkatës (Aneksi 3).

Bazuar në Anekset 2 dhe 3, nga verifikimet teknike te kryera nga grupi i punës, rezulton se aplikuesi plotëson të gjitha kushtet (teknike, metrologjike, ambientale etj,) si dhe të mbikqyrjes/kontrollit nga autoriteti doganor.

Duke qenë se plotësohen kërkesat ligjore, jemi të mendimit se aplikuesi duhet të pajiset me autorizim për magazinë fiskale/ miratohen ndryshimet në autorizim.

Shënim: Përveç informacionit të mësipërm, i cili është i detyrueshëm, në varësi të rrethanave mund të shkruhet çdo lloj informacioni tjeter që konsiderohet i nevojshëm.

Konceptoi:

Miratoi:



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE.....

ANEKSI 5

OPINION

Mbi kërkesën për Autorizim për administrim të magazinës fiskale/ndryshimeve në autorizim

Aplikuesi me NIPT dhe
Adresë.....

Ka kërkuar pranë Degës Doganore për t'u pajisur me autorizim për administrimin e një magazine fiskale Prodhimi/stokimi të produkteve alkolike/energjitike më datë.....

Dega Doganore pasi kreu të gjitha veprimet e parashikuara, në procedurën për dhënien e autorizimit për magazinë fiskale referuar raportit përbledhës të hartuar nga grupi i punës (Anekxi 4) i ngritur me nr. _____ prot., datë ____ / ____ / ____ vëren se:

Nuk ka mangësi në dokumentacion apo problematika që cënojnë funksionimin korrekt të regjimit të magazinës fiskale dhe mbikëqyrjes së saj.

Duke qenë se plotësohen kërkesat ligjore, jemi të mendimit se aplikuesi duhet të pajiset me autorizim për magazinë fiskale.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI

DEGA DOGANORE

Shënim: Përveç informacionit të mësipërm, i cili është i detyrueshëm, në varësi të rrethanave mund të shkruhet çdo lloj informacioni tjeter që konsiderohet i nevojshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE.....

ANEKSI 5.1

OPINION

Mbi kërkësen për shtesa apo ndryshime në Autorizim

Operatori me NIPT

Nr. autorizimit.....

Adresë.....

Ka kërkuar pranë dëgës doganore për disa shtesa / ndryshime në autorizim për administrimin e magazinës fiskale prodhimi/stokimi më datë ____ / ____ / ____.

Dega Doganore pasi kreu të gjitha veprimet e parashikuara, në procedurën për ndryshime në autorizim, për magazinë fiskale referuar raportit përbledhës të hartuar nga grupi i punës (Aneksi 4) vëren se:

Ndryshimet e kërkua nga operatori janë të pasqyruara me dokumentacionin e duhur dhe nuk cënojnë funksionimin korrekt të regjimit të magazinës fiskale dhe mbikëqyrjes së saj.

Duke qenë se plotësohen kërkësat ligjore, jemi të mendimit se operatorit duhet ti miratohen ndryshimet e kërkua nga autorizim.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI

DEGA DOGANORE

Shënim: Përveç informacionit të mësipërm, i cili është i detyrueshëm, në varësi të rrethanave mund të shkruhet çdo lloj informacioni tjetër që konsiderohet i nevojshëm.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I AKCIZËS

ANEKSI 6

RELACION SHPJEGUES

Ky relacion , hartoitet nga sektori i autorizimeve në Drejtorinë Teknike, në zbatim të procedurës për dhënien e Autorizimit për magazinë fiskale.

Qëllimi i këtij relacioni:

Është që të informojë në mënyrë të përbledhur Titullarin e Departamentit/Institucionit nëse dokumentacioni i paraqitur, dhe kushtet teknike, ambientale, metrologjike, teknologjike etj, të magazinës fiskale (për të cilën aplikohet) janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Përshtkimi

Operatori, ka paraqitur kërkesën për aplikim për magazinë fiskale pranë DD më datën ____ / ____ / ____.

Dega Doganore ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi, si dhe ka kryer vizitën në ambientet e magazinës fiskale (aplikuesit) me qëllim verifikimin teknik në përputhje me procedurën dhe brenda afateve ligjore/jashtë afateve ligjore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se dokumentacioni është i plotë dhe përmban të gjithë informacionin e kërkuar në të.

Bazuar në anekset 4 dhe 5, përkatësisht “raporti përbledhës i grupit të punës” dhe “opinionit” të Degës Doganore, rezulton se aplikuesi plotëson të gjitha kushtet (teknike, metrologjike, ambientale etj,) si dhe të mbikqyrjes/kontrollit nga Autoriteti Doganor.

Duke qenë se plotësohen kërkesat ligjore, jemi të mendimit se aplikuesi duhet të pajiset me autorizim për magazinë fiskale.

Shënim: Përveç informacionit të mësipërm, i cili është i detyrueshëm, në varësi të tretianave mund të shkruhet çdo lloj informacioni tjeter që konsiderohet i nevojshëm.

Konceptoi:

Miratoi: